



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurorja e Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 15 dhjetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit**

---

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Kadri Veselit ("z. Veseli" ose "i akuzuari") është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme në lidhje me paraburgimin. Zhvillimet përkatëse që nga rishikimi i dymbëdhjetë i paraburgimit të z. Veseli më 16 tetor 2023 ("Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin")<sup>1</sup> përfshijnë si vijon.

2. Më 24 nëntor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime mbi rishikimin e trembëdhjetë të paraburgimit të z. Veseli ("Parashtrimet e ZPS-së").<sup>2</sup>

3. Më 6 dhjetor 2023, Mbrojtja e z. Veseli ("Mbrojtja e Veselit") dorëzoi përgjigjen ndaj Parashtrimeve të ZPS-së ("Përgjigjja").<sup>3</sup>

4. Gjykimi kundër z. Veseli dhe të bashkakuzuarve vijon.

## II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Gjykata e Apelit dhe ky Trup Gjykues në shumë raste kanë përcaktuar se mbajtja në paraburgim e z.

---

<sup>1</sup> F01861, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 16 tetor 2023.

<sup>2</sup> F01995, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 24 nëntor 2023.

<sup>3</sup> F01985, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 6 dhjetor 2023, konfidencial.

Veseli është e përligjur.<sup>4</sup> ZPS-ja argumenton se që nga vendimi i fundit mbi rishikimin e paraburgimit të z. Veseli nuk ka pasur asnjë ndryshim material të rrethanave që do të përligjte një përfundim të ndryshëm.<sup>5</sup> ZPS-ja parashtron se ecuria e gjykimit dhe zhvillimet e konsiderueshme kohëve të fundit bëjnë edhe më të nevojshëm mbajtjen në fuqi të masave mbrojtëse aktuale.<sup>6</sup> Së fundi, ZPS-ja parashtron se, asnjë kusht tjetër përveç paraburgimit në objektin e paraburgimit nuk do të mjaftonte për të zvogëluar rreziqet që lidhen me lirimin e të akuzuarit,<sup>7</sup> dhe se paraburgimin mbetet proporcional në këto rrethana.<sup>8</sup>

6. Mbrojtja parashtron se parashtrimi i ZPS-së kërkon një përgjigje për të korrigjuar keqinterpretimet në lidhje me pretendimin e ZPS-së për "zhvillimet e konsiderueshme të kohëve të fundit" në mbështetjetë vazhdimit të paraburgimit të z. Veseli.<sup>9</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Dispozitat ligjore përkatëse për të vendosur mbi paraburgimin përfshihen në nenin 41 dhe rregullat 56 dhe 57 dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme. Trupi Gjykues do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.<sup>10</sup>

---

<sup>4</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1.

<sup>5</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

<sup>6</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 26.

<sup>7</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 21-26.

<sup>8</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 27-29.

<sup>9</sup> Përgjigja, para. 4.

<sup>10</sup> *Shih, ndër shumë të tjerë*, F00576, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me Vendimin mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kthyer për Rishqyrtim dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 23 nëntor 2021, konfidencial, para. 41, me referenca të mëtejshme. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 8 dhjetor 2021, F00576/RED.

#### IV. DISKUTIM

8. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që Trupi Gjykses të përcaktojë nëse ekzistojnë ende arsytet për mbajtjen në paraburgim.<sup>11</sup> Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse ngrihet para trupit gjykses përkatës ose *proprio motu*.<sup>12</sup>

9. Vlerësimi i Trupit Gjykses kufizohet në rishikimin e faktorëve të shqyrtuar më parë në përputhje me nenin 41(6), dhe në përcaktimin nëse këto rrethana vazhdojnë të ekzistojnë në mungesë të ndonjë zhvillimi të ri dhe përligjin vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli.

##### A. KRITERET E NENIT 41

###### 1. Dyshimi i bazuar

10. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) fillimisht kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS"). Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.<sup>13</sup>

11. ZPS-ja parashtron se vijon të përmbushet kriteri i nenit 41(6)(a). Për mendimin e ZPS-së, që nga vendimet e konfirmimit nuk ka pasur zhvillime të reja që mund të ndryshojnë konstatimin se ekziston dyshimi i bazuar se z. Veseli është penalisht përgjegjës për krimet e përfshira në aktakuzën e ndryshuar. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se është konfirmuar në mënyrë të përsëritur se vazhdon të ekzistojë

---

<sup>11</sup> IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, IA022/F00005/RED.

<sup>12</sup> IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, IA010/F00008/RED.

<sup>13</sup> *Ngjashëm*, ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

dyshimi i bazuar mirë se z. Veseli ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.<sup>14</sup>

12. Trupi Gjykses thekson se, në bazë të nenit 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi se ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Veseli është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).<sup>15</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se dyshimi i bazuar mirë është vërtetuar dhe në lidhje me akuzat e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Veseli, të paraqitura në ndryshimet e kërkuara që i janë bërë Aktakuzës.<sup>16</sup> Trupi Gjykses rikujton gjithashtu se këto konstatime u bënë mbi

---

<sup>14</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

<sup>15</sup> F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a)(i)-(ii). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar në F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020, publike; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial, të korrigjuar dhe me më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01.

<sup>16</sup> F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial (F00777/CONF/RED) dhe versioni i redaktuar publik (F00777/RED) u dorëzuan përkatësisht më 22 prill 2022 dhe 6 maj 2022. Versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 16 maj 2022 (F00777/CONF/RED2). Ndryshimet e kërkuara paraqiten me hollësi në para. 11. Më pas, aktakuza e ndryshuar e konfirmuar u dorëzua nga ZPS-ja më 29 prill 2022 ("Aktakuza e Konfirmuar"), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar më tej, konfidenciale, u dorëzua më 30 shtator 2022 (F00999/A01), me versionin e redaktuar publik (F00999/A03). Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 15 shkurt 2023 (F01296/A03) dhe 27 shkurt 2023 (F01323/A01).

bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).<sup>17</sup>

13. Në mungesë të ndonjë rrethane materiale të re që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykes gjykon se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Veseli ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, të parapara në nenin 41(6)(a) dhe (10).

## 2. Domosdoshmëria e parburgimit

14. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e parburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) në bazë të të cilave mund të konstatohet se parburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së veprave penale të mëtejshme.<sup>18</sup> Parburgimi vazhdohet nëse ka arsye të artikulueshme për të besuar se një ose më shumë nga këto rreziqe do të materializohet.<sup>19</sup> Trupi Gjykes vë në dukje se “të artikulueshme” në këtë kontekst përdoret në kuptimin që arsyet duhet të specifikohen me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave përkatëse.<sup>20</sup> Në përcaktimin nëse ekziston ndonjëri prej arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për parburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.<sup>21</sup>

<sup>17</sup> IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Parburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, IA008/F00004/RED.

<sup>18</sup> ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, 9 February 2021, [Judgment](#), para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, 17 September 2020, [Judgment](#), para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, 4 July 2019, [Judgment](#), para. 155.

<sup>19</sup> IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendim mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, IA004/F00005/RED.

<sup>20</sup> Neni 19.1.31 30 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Ligji nr.08/L-032, jep këtë përcaktim për termin “artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

<sup>21</sup> Vendimi mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 22.

## (a) Rreziku i arratisjes

15. ZPS-ja argumenton se z. Veseli tani është i vetëdijshëm për akuzat e rënda të konfirmuara kundër tij, për mundësinë e dënimit me burgim të gjatë dhe për provat që do të paraqiten në lidhje me ato krime. ZPS-ja argumenton se vazhdimi i gjyqimit e shton më tepër rrezikun e arratisjes. ZPS-ja parashtron gjithashtu se z. Veseli u përfshi në sjellje të dëmshme për integritetin e procesit gjyqësor dhe sigurinë e dëshmitarëve.<sup>22</sup> ZPS-ja argumenton se, megjithëse më parë Trupi Gjyqësor njohu bashkëpunimin e z. Veseli me autoritetet përkatëse për paraburgimin e tij, “gjendja aktuale” nuk qëndron kështu.<sup>23</sup> Së fundi, ZPS-ja parashtron se kombinimi i të gjithë këtyre faktorëve shton rrezikun e arratisjes së z. Veseli në një “mundësi të mjaftueshme reale”.<sup>24</sup>

16. Mbrojtja parashtron se Trupi Gjyqësor ka konstatuar në mënyrë përputhëse se vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli nuk mund të përlligjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes.<sup>25</sup> Mbrojtja parashtron se asnjë prej dëshmitarëve që kanë dëshmuar deri më 13 nëntor 2023, nuk ka shtuar asgjë në lidhje me provat dhe akuzat e Prokurorisë kundër z. Veseli, dhe thekson se ZPS-ja nuk ka vënë në dukje asnjë provë konkrete në këtë aspekt.<sup>26</sup> Mbrojtja përsërit se ZPS-ja nuk ka vënë në dukje asnjë provë se z. Veseli ka tentuar të ndërhyjë ndaj integritetit të procesit gjyqësor ose të rrezikojë sigurinë e dëshmitarëve.<sup>27</sup> Mbrojtja parashtron gjithashtu se ZPS-ja nuk vë në dukje se çfarë përfshin “gjendja aktuale”, ose si ajo mbështet pretendimin se do të shtonte rrezikun e arratisjes së z. Veseli në një mundësi mjaftueshëm reale. Për këto arsye, Mbrojtja argumenton se pretendimet e ZPS-së

---

<sup>22</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 21.

<sup>23</sup> Parashtrimi i ZPS-së, para. 21.

<sup>24</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

<sup>25</sup> Përgjigja, para. 8.

<sup>26</sup> Përgjigja, para. 10.

<sup>27</sup> Përgjigja, para. 11.

lidhur me rrezikun e pretenduar të arratisjes duhet të hidhen poshtë si të pabaza dhe dëmtuese.<sup>28</sup>

17. Trupi Gjykses ka shqyrtuar argumentet e ZPS-së, duke mbajtur parasysh fazën aktuale të procesit, dhe rikonfirmon se nuk konstatoi faktorë të tjerë që ta bindnin mjaftueshëm për të ndryshuar konstatimin e vet të mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes.

18. Sa i përket argumentit të ZPS-së në lidhje me avancimin e ecurisë së procesit, Trupi Gjykses vë në dukje se, në rrethanat aktuale, nuk është bindës argumenti i përgjithshëm i ZPS-së se shtohet rreziku i arratisjes në kontekst të vazhimit të gjykimit. Fakti që zhvillimet e fundit mund të minojnë ose të zhbëjnë sugjerimin e bashkëpunimit të plotë nga ana e z. Veseli nuk përforcon sugjerimin se rreziku i arratisjes është shtuar për shkak të këtij fakti.<sup>29</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin e vet se ekziston “mundësi e mjaftueshme reale” që i akuzuari të arratiset në qoftë se lirohet në bazë të fazës së procesit gjyqësor.<sup>30</sup>

19. Trupi Gjykses ka shqyrtuar argumentet e ZPS-së duke mbajtur parasysh fazën aktuale të procesit dhe, ndonëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet asnjëherë plotësisht, Trupi Gjykses rikonfirmon se nuk konstatoi faktorë të tjerë që ta bindnin mjaftueshëm për të ndryshuar konstatimin e vet të mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes.

20. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli aktualisht nuk mund të përlegjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

---

<sup>28</sup> Përgjigjja, para. 12.

<sup>29</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

<sup>30</sup> *Shih* Vendimin mbi Apelin e *Thaçit* lidhur me Lirimimin e Përkohshëm, para. 24.

(b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

21. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të këtij Trupi Gjykues, ZPS-ja parashtron se z. Veseli vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.<sup>31</sup> ZPS-ja argumenton se në Kosovë vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjes në procedurat penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), që, sikurse u përcaktua nga Gjykata e Apelit, është “faktor kontekstual” relevant.<sup>32</sup> Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se z. Veseli ka marrë informacion në lidhje me dëshmitarët që ZPS-ja synon të thërrasë për blloqet e ardhshme të dëshmive dhe do të vazhdojë të marrë këtë informacion çdo tre muaj, dhe se shtohet rreziku i pengimit të procesit me zbulimin gjatë gjykimit të identitetit të dëshmitarëve të mbetur për të cilët është miratuar nxjerrje e vonuar e informacionit.<sup>33</sup> Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtron se rreziku i zbulimit të paligjshëm të informacionit konfidencial nga z. Veseli tashmë është materializuar.<sup>34</sup> Sipas ZPS-së, kjo tregon se rreziku i pengimit të procesit është i bazuar mirë, dhe se sjellja e z. Veseli është e dëmshme për sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve dhe drejtpërdrejt dëmton integritetin e procesit.<sup>35</sup>

22. Sa u përket argumenteve të ZPS-së në lidhje me nxjerrjen e pretenduar të informacionit konfidencial për dëshmitarët nga ana e z. Veseli, Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykues theksoi se nuk do të bënte konstatime nëse i akuzuari në fakt kishte shkelur Rregulloren.<sup>36</sup> Mbrojtja përsërit se nuk pranon pretendimet e ZPS-së se z. Veseli ka “shpërndarë” përmbajtjen e dëshmive konfidenciale të dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>37</sup> Së fundi, Mbrojtja parashtron se argumenti i ZPS-së sipas të cilit z. Veseli mund të pengojë procesin ose të kryejë vepra penale të

---

<sup>31</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 10-15.

<sup>32</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

<sup>33</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

<sup>34</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

<sup>35</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 15.

<sup>36</sup> Përgjigja, para. 14.

<sup>37</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 15.

mëtejshme, bazuar në fakte të reja, nuk është asgjë tjetër veçse hamendësim i pabazë.<sup>38</sup>

23. Trupi Gjykses tërheq vëmendjen në lidhje me standardin e përdorur në vlerësimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b), që nuk kërkon “shembull konkret” të një situate ku z. Veseli ka frikësuar ose ngacmuar personalisht një dëshmitar.

24. Trupi Gjykses ka përcaktuar tashmë dhe rikonfirmon se: (i) z. Veseli ka aftësinë që t’i japë udhëzime një personi që ndërvepron me DHS-në dhe, duke e bërë këtë, ai ndërhyri drejtpërdrejt në një rast që përfshin DHS-në; (ii) z. Veseli vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në Kosovë për shkak të posteve të mëparshme të tij, gjë e cila do të vazhdojë t’i mundësojë, për shembull, qasje në informacion ose që të kërkojë mbështetjen e të tjerëve; (iii) në kohën që z. Veseli ishte shef i Shërbimit Informativ të Kosovës (“SHIK”), anëtarë të SHIK-ut u përfshinë në ndërhyrje ndaj dëshmitarëve; dhe (iv) avancimi i gjykimit i krijon z. Veseli mundësinë të njihet me provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.<sup>39</sup>

25. Duke marrë parasysh vazhdimin e procesit të gjykimit, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren për Mbrojtjen e Veselit, dhe për rrjedhojë, do të bëhen të njohura për shumë persona, përfshirë të akuzuarin. Kjo, nga ana e saj, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të japin dëshmi. Në këtë kontekst, lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte në mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.<sup>40</sup>

---

<sup>38</sup> Përgjigjja, para. 19.

<sup>39</sup> *Shih* F01303, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit*, 17 shkurt 2023, para. 24, me referenca të mëtejshme.

<sup>40</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 25.

26. Gjithashtu, në Kosovë vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjes në procedurat penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së, që nuk mund të mënjanohet vetëm me masa mbrojtëse.<sup>41</sup>

27. ZPS iu referua gjithashtu incidenteve të fundit të cilat bënë që Trupi Gjykses të urdhëronte masa shtesë për kufizimin e mundësisë së z. Veseli për të pasur kontakte ose vizita në objektin e paraburgimit. Në vendimin e vet mbi këto pretendime, Trupi Gjykses theksoi qartë se masat e urdhëruara në këtë kontekst janë parandaluese e jo ndëshkuese.<sup>42</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje se dokumentacioni në të cilin bazoi atë vendim mbështet më tej praninë e mundshme të rrezikut se z. Veseli mund t'u zbulojë informacion konfidencial palëve të treta të paautorizuara.<sup>43</sup>

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

(c) Rreziku i kryerjes së veprave penale të mëtejshme

29. ZPS-ja rikujton konstatimet e Trupit Gjykses në Vendimin e Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin dhe parashtron se z. Veseli vazhdon të përbëjë rrezik të kryerjes së veprave penale të mëtejshme.<sup>44</sup>

30. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të kryejë vepra penale të mëtejshme.<sup>45</sup> Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë vlejné dhe për shqyrtimin e rrezikut të kryerjes së veprave penale të mëtejshme nga z. Veseli.

---

<sup>41</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 26. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit*, 19 janar 2023, para. 57. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR.

<sup>42</sup> F01977, Trupi Gjykses, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin* ("Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit"), 1 dhjetor 2023, para. 30, 34.

<sup>43</sup> Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit, para. 35.

<sup>44</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-20.

<sup>45</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 26.

31. Trupi Gjykses thekson faktin se gjykimi në këtë çështje gjyqësore vazhdon dhe se identitetet e dëshmitarëve të cënueshëm i janë bërë të ditur Mbrojtjes së Veselit, dhe se duhet të shmanget çdo rrezik i kryerjes së veprave penale të mëtejshme.

32. Trupi Gjykses gjykon, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli të kryejë vepra penale të mëtejshme sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

### 3. Përfundim

33. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se aktualisht para tij vazhdon të mos ketë informacion të mjaftueshëm që do të përligjte konstatimin se z. Veseli mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë, në bazë të standardit përkatës, Trupi Gjykses është bindur se ekziston rreziku që z. Veseli të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe të kryejë vepra penale të mëtejshme kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykses do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirimin e tij trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme këto rreziqe.

#### B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

34. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se rreziqet përkatëse mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe se që nga vendimi i fundit nuk ka ndryshuar asgjë që do të përligjte një vlerësim të ndryshëm.<sup>46</sup> ZPS-ja parashtron më tej se sjellja e z. Veseli tani përbën rrezik jashtëzakonisht më të madh, sa që as

---

<sup>46</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 21-25.

kufizimet standarde të komunikimit dhe monitorimit në objektin e paraburgimit nuk janë të mjaftueshme për zvogëlimin e tij.<sup>47</sup>

35. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b).<sup>48</sup> Neni 41(12) përcakton disa faktorë që duhet të merren parasysh për të siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se paraburgimi duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme masa alternative më të buta të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).<sup>49</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat e arsyeshme alternative që mund të vendosen, dhe jo vetëm ato që parashtrajnë palët.<sup>50</sup>

36. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe kryerjes së veprave penale të mëtejshme, Trupi Gjykses rikonfirmon se asnjë nga masat e parapara në nenin 41(12) nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.<sup>51</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se masat në fuqi në objektin e

<sup>47</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

<sup>48</sup> Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar “masa alternative”, shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* (“Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017”), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012 (“*Idalov v. Russia* [GC]”), para. 140 *in fine*.

<sup>49</sup> Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140 *in fine*.

<sup>50</sup> IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 86. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 shkurt 2022, IA003/F00005/RED; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

<sup>51</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 35.

paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme.<sup>52</sup> Për më tepër, ato ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të identifikohet dhe/ose të parandalohet me lehtësi.<sup>53</sup>

37. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikonfirmon se vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së, përfshirë masat që urdhëroi Trupi Gjykses së fundi,<sup>54</sup> komunikimet e z. Veseli mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të mëtejshme.<sup>55</sup>

38. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të mëtejshme mund të trajtohet në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli është i domosdoshëm për të shmangur rreziqet në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

### C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

39. ZPS-ja argumenton se paraburgimi i z. Veseli vazhdon të jetë proporcional, veçanërisht duke mbajtur parasysh ecurinë e arsyeshme të procesit.<sup>56</sup>

40. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria e vazhimit të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe në përputhje me veçoritë e saj.<sup>57</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, ndër veçoritë

---

<sup>52</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 35.

<sup>53</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 35.

<sup>54</sup> *Shih* Vendimin mbi Kushtet e Paraburgimit, para. 84.

<sup>55</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 36.

<sup>56</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 27-29.

<sup>57</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 39.

e kësaj çështjeje gjyqësore përfshihen: (i) kundër z. Veseli janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm;<sup>58</sup> (ii) z. Veseli mund të dënohet me burgim të gjatë nëse shpallet fajtor;<sup>59</sup> (iii) rreziqet e përcaktuara në nenin 46(b)(ii) dhe (iii) nuk mund të zvogëlohen me asnjë kusht;<sup>60</sup> (iv) çështja kundër z. Veseli është komplekse;<sup>61</sup> dhe (v) faktin se gjykimi është në zhvillim e sipër, që tregon ecuri të arsyeshme të procesit.

41. Duke marrë parasysh zhvillimet e mësipërme, si dhe faktin se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të mëtejshme, që nuk mund të zvogëlohet mjaftueshëm me zbatimin e masave të arsyeshme alternative, Trupi Gjykes konstaton se vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli me dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje.

42. Megjithatë, Trupi Gjykes thekson se i akuzuari tashmë mbahet në paraburgim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe gjykimi i kësaj çështjeje ka mundësi të zgjasë. Sikurse u vu në dukje më herët nga Trupi Gjykes, kjo kërkon që si Trupi Gjykes, ashtu edhe palët, të kenë veçanërisht parasysh që të sigurojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykes do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

## V. KLASIFIKIMI

43. Trupi Gjykes vë në dukje se Përgjigjja u dorëzua si konfidenciale. Trupi Gjykes rrjedhimisht urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes, ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike deri më 4 janar 2024.

---

<sup>58</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 39.

<sup>59</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 39.

<sup>60</sup> *Më lart*, para. 37.

<sup>61</sup> Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Paraburgimin, para. 39.

## VI. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli;
- b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli jo më vonë se të hënën, 29 janar 2024 në orën 16:00, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes, ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike, deri më 4 janar 2024.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**  
**Kryegjykatës**

E premte, 15 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.